

ABU Seman
Nr. prot 341
Date 29/09/2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM

Nr. 36 Datë 13/ 09 /2017

Për miratimin e lejes për shfrytëzimin të burimit ujor, lumi Osum në Corovodë Bashkia Skrapar Qarku Berat për ujë teknologjik nga subjekti "SPIECAPAG"

Në mbështetje të ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" neni 5, neni 12 pika 1, neni 13 pika 2 d, neni 41, neni 50 pika 2. Vendimit Nr 416 datë 13.05.2015 Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumentave shoqërore, afatit të vlefshmerisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore". Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr 5 datë 16.02.2016 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujorë si dhe Vendimi të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr 6 datë 16.02.2016 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujorë"
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman.

VENDOSI:

Miratimin e lejes për shfrytëzimin të burimit ujor, ujor, lumi Osum në Corovodë Bashkia Skrapar Qarku Berat për ujë teknologjik nga subjekti "SPIECAPAG"

Kordinatat e pikës KP 107 + 200 janë si më poshtëme :

X = 43 19 29.183 Y = 44 84 490.676 Z = 251.7 m

Me prurja e burimit ujor është $Q_{min} = 2.10 \text{ m}^3/\text{sek}$
Sasia që jepet në përdorim është $Q = 30000 \text{ m}^3/\text{vit}$ ($2500 \text{ m}^3/\text{muaj}$) me kushtin që të mbeten të pa prekur 30% e sasise së ujit për prurje ekologjike dhe plotësimi i dosjes me Oponencën nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptarë

Ngarkohet AUB Seman për zbatimin e këtij vendimi.

KRYETARI I KBU SEMAN
Vasil Bregu

PËRGJEGJËSI AUB SEMAN

Isuf Myrtaj

